

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR EUROBONDIN QË DO TË EMETOHET NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE BLERJEN MBRAPSHIT (BUYBACK) TË NJË PJESE TË EUROBONDIT EKZISTUES, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGATAKSAT E TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË NGA IMUNITETIN NË MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Për efekt të respektimit të kërkesave ligjore, kushtetuese dhe të garantimit të një procesi sa më transparent, ky projektligj ka si qëllim që në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e këtij transaksioni dhe që i bashkëlidhen dhe me objekt miratimin e përjashtimeve nga taksat të çdo transaksioni të kryer dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti, në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë) për emetimin e instrumentit “Eurobond” dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues, në përputhje me ligjin nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Transaksioni i daljes në tregun ndërkombëtar nëpërmjet Eurobondit ka natyrë të ngjashme me emetimin e borxhit në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve qeveritarë, rasti i obligacioneve me afat maturimi afatmesëm/afatgjatë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i propozuar është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Eurobondi është një instrument me afat maturimi më shumë se një vit, i cili emetohet në monedhë të huaj në tregun ndërkombëtar. Eurobondi i parë për Republikën e Shqipërisë është emetuar në vitin 2010, ndërkohë dalja e dytë në

tregjet ndërkombëtare të kapitalit është bërë në vitin 2015, ku është emetuar eurobond me madhësi 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, me afat maturimi 5-vjeçar dhe me një normë interesi 5.75%, i cili maturohet më 12 nëntor 2020.

Emetimi i eurobondit në tregjet ndërkombëtare në vitin 2018, me madhësi maksimumi deri në 500 000 000 (pesëqind milionë) euro, me afat maturimi 5-10 vjet vlerësohet si mënyra optimale si për të plotësuar nevojat për financim për dy vitet në vijim, ashtu edhe për të mundësuar optimizimin e menaxhimit aktiv të detyrimeve të borxhit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, do të shoqërohet me blerje mbrapsht (*buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro që maturohet më 12 nëntor 2020. Emetimi i këtij instrumenti është në përputhje të plotë me objektivat e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik, të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Dalja e Shqipërisë sërish në tregjet ndërkombëtare të kapitalit pas 3 vjetësh mungese është një sinjal mjaft pozitiv për sa u përket kredencialeve të vendit tonë dhe rritjes së besimit të investitorëve në ekonominë e vendit. Gjithashtu, emetimi me sukses i eurobondit do të ishte një garanci më shumë për sa i përket përmirësimit të strukturës së borxhit dhe uljes së kostos në portofolin e borxhit.

Në këtë eurobond synohen të futen disa elemente të reja si zgjerimi i formatit (me 144A) për të rritur aksesin në tregjet e SHBA-ve përveç tregjeve evropiane dhe menaxhimi i detyrimeve nëpërmjet *Buyback*.

-Procedura *Buyback* me ankand blerjeje mbrapsht (*tender offer*) maturimi i parakohshëm

Buyback është një procedurë e cila të lejon të tërheqësh para kohe (para maturimit) një instrument ekzistues (ndryshe blerje mbrapsht e një titulli). Blerja realizohet me shumat e marra nga emetimi i eurobondit të ri. Kjo procedurë është brenda kuadrit ligjor bazuar si tek ligji i borxhit dhe te marrëveshja me Bankën e Shqipërisë.

Buyback gjen një aplikim të rëndësishëm në praktikat ndërkombëtare të menaxhimit të borxhit publik. Praktika ndërkombëtare tregon se është një ushtrim i cili ka disa përfitime si cilësore ashtu dhe sasiore.

Procedura e *Buyback*-ut është përdorur në tregun e brendshëm të titujve qeveritarë në vitin 2015 pas daljes në tregun ndërkombëtar. Një objektiv i rëndësishëm për zbatimin e *Buyback*-ut është ulja e riskut të refinancimit sidomos në vitin 2020 kur nevojat janë relativisht të larta (mbi 700 mln euro). Gjithashtu, në bazë të pritshmërive parapagesa në vitin 2018 për instrumentin që maturohet në vitin 2020 mundëson dhe një kursim të mundshëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rreth një vit që është duke u angazhuar dhe duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për një emetim të suksesshëm të këtij instrumenti.

Procesi i emetimit të eurobondit ka kaluar në disa etapa të rëndësishme, midis të cilave:

1. Është ndryshuar baza ligjore për të akomoduar daljen në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, duke filluar që nga viti 2015, me qëllim rritjen e fleksibilitetit të huamarrjes me instrumente financiare që shtetit shqiptar t'i lehtësohet aksesin në tregjet financiare ndërkombëtare duke synuar në uljen e kostos së huamarrjes shtetërore.
2. Rregullimin ligjor ku nivelet e huamarrjes shtetërore të përcaktuara në ligjin e buxhetit të zbatohen në mënyrë fleksibël për të garantuar nivele më të kënaqshme të kostove.
3. Janë përzgjedhur rregulluesit kryesorë (*Joint Lead Managers*) të cilët do të drejtojnë procesin e emetimit të eurobondit. Këto banka janë Citi, Banca IMI, Societe Generale, me eksperiencë në tregjet e kapitalit dhe transaksionet financiare. Këto banka do të menaxhojnë përmbushjen e të gjitha detyrimeve procedurale dhe teknike të nevojshme për realizimin e emetimit të eurobondit dhe do të rrisin interesin e investitorëve që do të jenë blerësit e këtij instrumenti.
4. Është përzgjedhur këshilltari ligjor ndërkombëtar për Shqipërinë, Dechert LLP, konsulenti ligjor i vitit 2015.
5. Janë organizuar një sërë takimesh me bankat/institucionet ndërkombëtare për të marrë informacion mbi mundësitë dhe kushtet e emetimit të një eurobondi në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2018.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e deritanishme të bankave ndërkombëtare që shfaqën interes për eurobondin shqiptar, mbi kohën më të mirë për realizimin e këtij transaksioni, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është duke punuar me intensitet të lartë që brenda muajit tetor 2018 Shqipëria të dalë në tregun ndërkombëtar me eurobondin e ri. Sipas vlerësimeve të paraqitura nga bankat ndërkombëtare, Shqipëria në 2018 ka mundësi që të pozicionohet më mirë se në vitin 2015 në tregun ndërkombëtar.

Ky vlerësim mbi një pozicionim të mundshëm më të favorshëm të Shqipërisë në tregun ndërkombëtar bazohet në:

- konsolidimin fiskal të realizuar në vitet e fundit të materializuar në balanca primare pozitive dhe vendosjen e nivelit të borxhit në një trajektore të qëndrueshme rënëse, në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskale të përcaktuara në vitin 2016 në ligjin organik të buxhetit;
- përshpejtimin e vijueshëm për disa vite rresht të rritjes ekonomike bazuar në përmirësimin e fondamenteve ekonomike dhe pritshmëritë pozitive për perspektivën afatmesme dhe afatgjatë;

- reformimin substancial deri më tani në menaxhimin e financave publike dhe pritshmëritë pozitive për ecurinë në vijim;
- tërësinë e reformave në një sërë fushash të tjera të realizuara deri me tani dhe ato të planifikuara për në vijim;
- progresin relativisht të kënaqshëm deri më tani në kuadër të integritetit në BE dhe perspektiva në vijim.

Financimi i siguruar nga eurobondi do të shërbejë :

1. për të plotësuar në mënyrë optimale nevojat për financim të viteve 2019 dhe 2020;
2. për të mundësuar një menaxhim të optimizuar të detyrimeve dhe instrumenteve të borxhit publik.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ndryshimet e propozuara në tërësi janë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh kompleksitetin e transaksionit të ndikuar nga ecuria e kushteve të tregut financiar ndërkombëtar në lidhje me sigurimin e fondeve monetare, në përputhje dhe me sugjerimet e bashkërregulluesve kryesorë (*Joint Lead Managers*), të cilët drejojnë procesin e eurobondit si dhe ndjekin në kohë reale kushtet e tregut financiar ndërkombëtar, i cili mund të pësojë ndryshime nga pikëpamja kosto/risk për realizimin e transaksionit, me qëllim arritjen e daljes me eurobond brenda muajit tetor 2018, kërkohet që projektligji të kalojë me procedurë të përshpejtuar dhe ligji të hyjë në fuqi menjëherë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Pojektligji ka dy nene nga të cilat në nenin 1 përcaktohet se në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit “Eurobond” dhe blerjen mbrapsht (*Buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues 450 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, në përputhje me ligjin nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në

tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Ndërsa në nenin 2 përcaktohen mbajtësit e titujve të eurobondit, menaxherët bashkëdrejtues dhe manaxheri për blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë përkatësisht nga të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e eurobondeve dhe me blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është dërguar për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Avokaturën e Shtetit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bankën e Shqipërisë, të cilat dërguan qëndrimin e tyre zyrtar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Transaksioni i emetimit të eurobondit ka efekte financiare, të cilat janë parashikuar dhe do të përballohen nga buxheti i shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE